



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Krujë, më 17.05.2022

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data 17.05.2022]

Drejtuar **[Subjekti: “KASTRATI” sh.p.k** me NIPT J61813529P , me administrator Shefit Kastrati, *Adresa:* DURRES Lagja 14, Rruga Tirana, Prane Gjykates se Apelit, Shkozet

* * *

Procedura e prokurimit: Procedura e Hapur

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Loti nr.1 -Blerje karburanti (gasoil 10 ppm)per Bashkine Kruje.

Nr References: REF-25859-04-20-2022

Fondi Limit (Loti nr.1): 36’394’882 (tridhjetë e gjashtë milion e treqind e nentdhjetë e kater mije e teteqind e tetedhjetë e dy) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Kontratat do te jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuader me Operatorët ekonomikë të sukseshëm për secilin lot, me **afat 24 (njëzet e katër) muaj** nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër për secilin lot.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini Nr. 53 datë 26 Prill 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Referuar nenit 45.2/1 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, njoftimit Nr. 2060 Prot, datë 23.03.2022 **dhe nenit 2 te Aktit Normativ nr 8 date 25.03.2022**

Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

- a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës (**brenda kufijve të miratuar në nenin 2 të aktit normativ nr 8 date 25.03.2022**).

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

OE: “KASTRATI” shpk
Emri i plotë i shoqërisë

J61813529P
numri i NIPT-it

VLERA E OFRUAR=36’394’882 (tridhjetë e gjashtë million e treqind e nentëdhjetë e katër mijë e teteqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Shenim: OE si me sipër ka paraqitur , normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute leke për liter)= **14.90** (katërmbëdhjetë e presje nentëdhjetë) leke për liter, e shprehur në norme fitimi në vlerë absolute

OE: “BUJARI – PETROL” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K87907301F
numri i NIPT-it

VLERA E OFRUAR=36’394’882 (tridhjetë e gjashtë million e treqind e nentëdhjetë e katër mijë e teteqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Shenim: OE si me sipër ka paraqitur , normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute leke për liter /Marzhi i fitimit i shprehur në %)= **4.9** (katër presje nentë) e shprehur në përqindje.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

OE: “BUJARI – PETROL” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K87907301F
numri i NIPT-it

VLERA E OFRUAR=36’394’882 (tridhjetë e gjashtë million e treqind e nentëdhjetë e katër mijë e teteqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Shenim: OE si me sipër ka paraqitur , normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute leke për liter /Marzhi i fitimit i shprehur në %)= **4.9** (katër presje nentë) e shprehur në përqindje.

Perkatesisht për arsyet si vijon:

Në piken 1 të Dokumentave Standarte të Tenderit është kërkuar që Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (në masën prej 2% e vlerës së fondit limit të lotit të I-re)

- Në nenin 82 të Ligjit Nr 162/2020 “Për Prokurimin Publik” është parashikuar që “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose

palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”,

Po ashtu ne Nenin 26 te VKM-se “Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik” kërkohej qe Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; 28
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Ne kundërshtim me pikën Nr.1 te DST-se, si edhe ne kundërshtim me Nenin 82 te Ligjit Nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe te Nenin 26 te VKM-se “Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”, subjekti nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhes ste Vetedeklarimit sipas shtojces 8, c’ka perben arsye per skualifikimin e tij.

- Ne nenin 83 te Ligjit Nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” eshte parashikuar qe “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”

Po ashtu dhe ne nenin Neni 30 te te VKM-se “Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave Të Prokurimit Publik” eshte parashikuar “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së”

Ne kundërshtim me piken Nr.1 te DST-se, si edhe ne kundërshtim me Nenin 83 te Ligjit Nr 162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe te Nenin 30m te VKM-se “Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik”, subjekti nuk ka paraqitur sigurimin e oferets sipas shtojces 3.

- Ne piken 2.3-2 te Dokumentave Standarte te Tenderit eshte kerkuar qe për arsye të nevojës së punës të mjeteve të drejtorisë së shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes dhe mjeteve të sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH) te cilat gjate proceseve operative te punes stacionohen ne terrene me akses te distancuar e kane te pamundur levizjen per tek stacionet e furnizimit duhet te qe furnizohen ne vend , per kete arsye , operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi të vet ose me qira të paktën 1 (një) mjet autobus. Për të provuar disponimin e tyre (në pronësi) shoqëria duhet të dorëzojë lejen e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, çertifikatë për transportin e mallrave të rezikshëm, Pasaportën e autobotit, çertifikatën e mbrojtjes nga zjarri dhe çertifikatën e verifikimit të kontabilitetit të lëshuar nga DPM. Nëse mjetet janë me qira, të paraqitet përveç dokumentacionit të mësipërm edhe kontrata noteriale e qirasë.

Ne kundërshtim me kete pike te DST-se Subjekti nuk ka paraqitur asnje dokument ligjor dhe teknik ku te vertetoje se disponon mjetin tip Autobot.

- Ne piken 2.3.3 te dokumentave standarte te tednerit eshte kerkuar qe Subjekti ofertues duhet te kete minimalisht 1(nje) stacion të tregtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Krujë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie,ose të jenë të pasqyruara në ekstratin tregtar të operatorit ekonomik pjesmarrës)

- a)Stacionet e tregëtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur liçencë per tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel)ose leje tregëtimi në përputhje me dhe në zbatim të Ligjit nr.8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre .”I ndryshuar dhe VKM Nr. 970, date 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

- Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur rezulton qe subjekti ka nje stacion te tregtimit me pakice te karburantit brenda territorit te bashkise Kruje te subjektit Bujari Oil te kontraktuar nga subjekti pjesemarrës ne tender, por nuk eshte paraqitur liçenca per tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel)ose leje tregëtimi në përputhje me dhe në zbatim të Ligjit nr.8450, date 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre .”I ndryshuar dhe VKM Nr. 970, date 2.12.2015“Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

Nderkohe qe kualifikohen per plotesim te kritereve te pergjithshme dhe te vecanta keto operatore ekonomike te rendituar sipas kriterit percaktues te ofertes fituese cmimi me ulet, operatoret ekonomik si vijon:

OE: **“KASTRATI” shpk**
Emri i plotë i shoqërisë

J61813529P
numri i NIPT-it

VLERA E OFRUAR=36'394'882 (tridhjetë e gjashtë milion e treqind e nentëdhjetë e katër mijë e teteqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Shenim: OE si me sipër ka paraqitur , normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute leke per liter)= 14.90 (katërmbëdhjetë presje nentëdhjetë) leke per liter, e shprehur ne norme fitimi ne vlere absolute

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

OE: “KASTRATI” shpk
Emri i plotë i shoqërisë

J61813529P
numri i NIPT-it

VLERA E OFRUAR=36'394'882 (tridhjetë e gjashtë milion e treqind e nentëdhjetë e katër mijë e teteqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa tvsh

Shenim: OE si me sipër ka paraqitur , normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute leke per liter)= 14.90 (katërmbëdhjetë presje nentëdhjetë) leke per liter, e shprehur ne norme fitimi ne vlere absolute

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Artur BUSHI

Konceptoi;G.Halili
Nr ekzemplareve:3k
Datë:_____.____.2022